

V E N D I M
Nr.406, datë 17.8.1993

PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

Në zbatim të ligjit nr. 7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit krijohet Drejtoria e shërbimit të mbrojtjes së bimëve, brenda së cilës ngrihet dhe funksionon Inspektoriati i mbrojtjes së bimëve dhe karantinës dhe Sekretaria e Komisionit Shtetëror të Pesticideve.

2. Në drejtorinë e bujqësisë dhe të ushqimit në çdo rreth caktohet inspektori i mbrojtjes së bimëve e karantinës dhe agronomi i mbrojtjes së bimëve në laborator.

3. Në pikat doganore kufitare të caktuara për hyrjen e bimëve, të produkteve bimore e pesticideve vendosen inspektorët e karantinës së jashtme, brenda numrit të punonjësve në organikë të miratuar për sistemin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Në pikat doganore me veprimtari 16-orëshe shërbimi i karantinës organizohet me dy ndërresa.

Inspektorët e karantinës së jashtme bimore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pikat doganore kufitare. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të bashkërendojë punën me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrinë e Rendit Publik për t'u siguruar atyre kushte normale pune.

4. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton uniformën dhe shenjën dalluese të shërbimit të karantinës bimore të Republikës së Shqipërisë dhe pajis me to inspektorët përkatës.

5. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të marrë masa për ngritjen dhe kompletimin e laboratorit qëndror të karantinës bimore në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, të laboratorëve të mbrojtjes së bimëve në rrethe dhe të laboratorëve të karantinës bimore në pikat doganore të hyrjes së bimëve dhe produkteve bimore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Në degët e bujqësisë pranë çdo komune caktohen agronomët e mbrojtjes së bimëve brenda organikave që kanë këto degë.

7. Në të gjitha strukturat e shërbimit të mbrojtjes së bimëve caktohen specialistë me kualifikimin përkatës.

8. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton tarifat për lëshimin e licencave, të çertifikatave fitosanitare etj. dhe analizat laboratorike.

9. Pagesat për shpenzimet administrative të regjistrimit, si dhe për kryerjen e provave biologjike-agronomike dhe mjekësore toksikologjike për regjistrimin e një pesticidi, bëhen nga personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, në llogarinë bankare të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të institucioneve përkatëse.

Ato administrohen me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit për shpenzimet dhe shpërblimet përkatëse të Komisionit Shtetëror të Pesticideve dhe hallkave të tjera që lidhen me regjistrimin, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.478, datë 7.11.1992.

10. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrë rregulla të hollësishme për detyrat e organeve të shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe të karantinës bimore.

11. Pesticidet që përdoren në bujqësi, nuk i nënshtrohen rregullave të caktuara në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 15.9.1976 "Për lëndët plasëse dhe helmet me efekt të fortë".

12. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të përgatitë rregulloren për importimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin, përdorimin dhe asgjësimin e pesticideve që përdoren në bujqësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

